



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 4, Datë 08.04.2014

PËR

MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR NDËRTIMIN E LINJËS SË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, 110 KV, ERSEKË-PËRMET

Në mbështetje të neneve 70/8 dhe 70/11 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për ndërtimin e linjës së transmetimit të energjisë elektrike 110 Kv Ersekë-Përmet, për shoqërinë “OST” Sh.a.
2. Bashkëlidhet harta e planvendosjes së strukturës, si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Formulari i Lejes Zhvillimore Komplekse i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.
4. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



Z. DAMIAN GJIKNURI

MINISTËR I ENERJISË DHE INDUSTRISE



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

